



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 37.

Prishtinë, më 31.01.2019 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N- 204

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti, Donika-Kadaj-Bujupi dhe Milaim Zeka.

Munguan: Adem Hoxha dhe Fikrim Damka.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

E ftuar Blerta Bejtullahu, përfaqësuese nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu -Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja e komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e komisionit dhe tha se siç jemi dakorduar dje po vazhdojmë sot me të njëjtin rend të ditës.

Rend i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-114 për zyrtarët publik, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

5. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua.

Kryetarja tha se siç e dini dje na kanë ardhur disa komente me vonesë nga Zyra e BE-së dhe ne e shtymë mbledhjen për sot për të pasur kohë për t'i analizuar dhe sot t'i shqyrtojmë.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja tha se fushëveprimi i këtij projektligji nuk rregullohet me legjislacion të BE-së, po ashtu edhe amendamentet e Komisionit Funkcional nuk rregullohen, sepse është kompetencë e shteteve anëtare që këtë fushë ta rregullojnë me rregullimin e brendshëm. Në vazhdim informoi se Komisioni për Legjislacion, dje ka bërë dy ndryshime me kërkesë të Zyrës së BE-së, sepse ka pasur interferenca në Kodin penal.

E hapi diskutimin.

Ismajl Kurteshi tha se për të mos e marr fjalën tri herë, pasi të njëjtën gjë do ta diskutoj, mendoj se këto 3 ligje janë shumë të rëndësishme për vendin tonë, por në to ka mangësi shumë të mëdha dhe ka shumë të meta, duhet shumë për t'u korrigjuar dhe mundësitë për t'u korrigjuar kanë kaluar, andaj unë do të abstenojë për të tri projektligjet, kurse në seancë do të vendosim se cili do të jetë qëndrimi i grupit parlamentar.

Armend Zemaj tha se edhe unë po e marr fjalën për tri ligjet, çdo njëri i ka specifikat e veta, por ndërlidhen me atë që ka qenë pritje dhe kërkesë e administratës publike, sipas mendimit tim dhe grupit parlamentar të LDK-së nuk është arritur të plotësohen kërkesat që kanë qenë në vazhdimësi për reformë të administratës shtetërore, sidomos te ligji i dytë, i cili ka të bëjë me agjencitë e pa varura. Kosova ka vuajtur dhe po vuan nga agjencitë e pa varura dhe kjo rritje enorme e këtyre agjencive e rrit edhe numrin e zyrtarëve të lartë publikë, të cilët për nga natyra e punës dhe marrëdhënia e punës që krijojnë i bëjnë vetëm dëm buxhetit të Republikës së Kosovës dhe nuk i afrojnë zhvillim vendit në shumë sfera. Ka qenë shpesh herë kërkesë e Kuvendit të Kosovës që shumë agjenci të inkorporohen, duke marrë për bazë që disa kanë mundur edhe në këtë fazë gjithmonë duke u thirrur në esencën e punëve dhe detyrave që ata i kanë.

Për këtë arsye është mirë që këto 3 projektligje të tërhiqen në Qeveri dhe ata ta kryejnë punën sipas kërkesave.

E vlerësoj lart punën e Komisionit Funkcional, por vërejtjet janë në përmbajtje të këtyre projektligjeve që kanë ardhur nga Qeveria dhe tentimi për ndryshimet është goxha substancial për të përmirësuar disa defekte të kërkuara që kanë dalë edhe nga debatet, edhe pse nuk kanë mundur të ngërthejnë në vete, sepse e dini që procedurat nuk lejojnë që ligji të ndryshohet në tërësi.

Në esencë këto 3 projektligje nuk kanë ardhur me pritjet dhe kërkesat që kanë qenë evidente gjatë këtyre viteve.

Zenun Pajaziti tha se pasi që këto 3 projektligje janë të ndërlidhura dhe ashtu u fillua, po i diskutoj edhe unë, lidhur me Projektligjin për pagat në sektorin publik i kam rezervat e mija, sepse mendoj që duhet me e trajtuar edhe me shikuar më tepër për mos me lënë diçka që mundet me u vazhduar me pakënaqësitë, por ne duhet me pasur parasysh që këto ligje na kanë munguar për shumë vite, këto nuk janë perfektë, por është hera e parë që po bëhet diçka serioze dhe mendoj që duhet me i votuar për me e bërë një hap, sa me shumë që shtyhet kushdo që do të jetë, pastaj do të ketë problem serioz me bërë ndryshime dhe ju ftoj me i votuar.

Ismet Beqiri pajtohet me deputetin Zemaj që ka probleme, veçanërisht me agjencitë, sepse janë aq pozita të shumëfishuara, sa që është absurde një punë që kishte mundur me e krye ministria për mes degëve të veta janë formuar agjenci mbi agjencitë, sidoqoftë ka e dhe shumë vërejtje tjera dhe nuk do ta përkrahi asnjërin prej këtyre 3 projektligjeve.

Fatmire Kollçaku pajtohet se këto 3 projektligje i kanë munguar Kosovës, por tha se për 20 vjet është dashtë me ardhur një reformë e vërtetë, qoftë e administratës, qoftë të rregullimit të çështjes së pagave, tani e kemi parë një nguti dhe një kaos që u krijua me këto 3 projektligje dhe debatin që e kanë zgjuar në shoqëri. Këto projektligje është dashtë të punohen shumë më hollësisht dhe të konsultohen grupet e interesit, sepse prek shumë njerëz në shtetin tonë dhe tani po e shohim një farë kulmi të pakënaqësisë. Unë tani nuk është që e përfaqësoj komunitetin e profesionistëve shëndetësorë, por megjithatë duke u bazuar në dokumente, qoftë të sindikatës, odes së mjekëve dhe qëndrimeve që i kemi marrë në komision. Ne tani në vend se ta kemi një projektligj të mirëpritur, tani po e shihni çfarë pakënaqësish ka, dhe tani Kuvendi me një shkop magjik nuk mund t'i rregullojë të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar si duhet me kohë. Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale ka bërë disa amendamente të cilat nuk janë përfillur nga Komisioni Funkcional, unë në këtë moment do të abstenoj, mirëpo kjo nuk e determinon votën në Kuvend.

Milaim Zeka tha se si anëtar edhe i Komisionit Funkcional, ku janë shqyrtuar këto 3 projektligje, po shoh se mungon komunikimi mes deputetëve të partive, p.sh. deputetëve të Vetëvendosjes të Ligji i pagave, ju mungon informacioni, edhe pse punën më serioze në këtë komision e kanë bërë deputetët e LDK-së dhe të Vetëvendosjes.

Mundohem gjithëherë që kur flas me fol në interes të shtetit, e dimë se sindikatat e shëndetësisë, bujqësisë dhe sportit, si dhe organizatat studentore në Kosovë janë pjellë e partive politike, interesave dhe grupimeve politike, mbi bazën e kësaj ne si deputetë do të ishte mirë me i harmonizua qëndrimet tona rreth ligjeve duke i lënë me një anë garat politike jashtë Kuvendit të Kosovës.

Që kemi vërejtje në Ligjin e pagave, normal që kemi edhe ne që kemi punuar në komision, por lind pyetja se a do ta kemi për herë të parë një ligj i cili fillon me e çmontua krimin që

është bërë me rritjen e pagave, ku drejtorët e Postës, KEK-ut dhe disa tjerë ia kanë caktuar vetes pagën 4 deri 6000 € dhe bëjnë shpenzime tjera enorme.

Te gjithë deputetët pa varësisht ngjyimeve partiake e kemi bërë një punë të mirë, përkundër presioneve të Zyrës së BE-së dhe që është bërë shpejt ky ligj, mendoj se është bërë një ligj shumë i mirë dhe mbi bazën e kësaj ju ftoj t'i votoni.

Visar Ymeri tha se me sa e di dhe sa jam i informuar, natyrisht këto 3 ligje janë draftuar së bashku me zyrën e BE-së dhe e bartin në vete një logjikë dhe një reformë administrative e cila është parë edhe e dobishme dhe në realitetin e rrethanave të cilat jetojmë në Kosovë, a kemi nevojë këtë ta rregullojmë dhe ta shtimë në një rend krahasuar me kaosin në administratë publike, normalisht që kemi, sepse kjo administratë shtetërore është parë që ka pasur mundësi dhe vazhdimisht është keqpërdor për qëllime elektorale, sa procese zgjedhore janë fituar prej partive në pushtet duke premtuar dhe rritur rrogat sektorëve të veçantë për me ju marr votën. Tani me Ligjin për pagat një gjë e tillë është e pa mundur me ndodhur, vetëm nëse shkelet ligji, sepse nëse do të bëhet rritja e pagave në sektorin publik do t'ju bëhet të gjithëve meqenëse është e bazuar në koeficient dhe kjo është një dobi që e sjell ky ligj.

Mendoj se është propozuar nga Qeveria gabimisht, veçanërisht kjo tabela e koeficienteve të sektorëve të ndryshëm në shoqëri, sepse ajo tabelë e ka reflektuar një ideologji të caktuar qeverisëse që e bënë Qeveria aktuale, varësisht se cilët prej sektorëve i konsideron më të rëndësishëm dhe i reflekton në shpërblimin nga paraja publike, dhe si sektorë më të rëndësishëm kanë qenë përfaqësuesit politikë, tash a është ndërhyrë për me përmirësuar sado pak këtë, po është ndërhyrë dhe është reduktua sado pak ky hendek në mes të pagave në sektorin publik, por jo aty ku kisha pasur qejf unë me ardhur, sepse prapë mendoj se koeficienti 10 për presidentin është i madh dhe së paku është dashtë me qenë 9 dhe proporcionalisht, pastaj për secilin prej përfaqësuesve politik dhe atyre në ekzekutiv me ju reduktua koeficienti në bazë të kësaj.

Konsideroj se ky ligj për paga me të gjitha të metat që i ka dhe të metat që i ka pasur dhe disa janë reduktuar, e ka përmirësuar sa do pak gjendjen dhe do ta bëjë më mirë. Pra, ka një rritje të pagave për shëndetësinë, arsimin më pak dhe ka një reduktim të pagave për ata që konsiderohen si krerë institucional shtetëror.

Kur flasim për reformën administrative që u ngrit më parë për numrin e madh të agjencive, po ka shumë agjenci, megjithatë kjo është një reflektim i mënyrës dhe qasjes qeverisëse të cilën e kemi pasur të ndërtuar tash e 20 vjet në Kosovë.

Agjencitë kanë nisur me u ndërtuar si parime ideologjike, por pastaj këto u shndërruan në interesa.

Jam dakord që qeverisja duhet me qenë përgjegjësi e ekzekutivit, e jo e shpërndarë në agjenci, që konsiderohen formalisht të pa varura. Problemi të këto agjenci nuk është se vetëm mundësia e re për punësim, por problemi është se pavarësia e tyre formale është shndërruar në një farë varësie absolutisht të pa dobishme për shoqëri, pra nga aktorët më të fuqishëm të tregut.

Problemi kryesor me këto 3 projektligje është se nuk janë diskutuar sa duhet dhe si duhet në momentin kur kanë qenë duke u draftuar.

Meqenëse këto ligje i adresojnë disa prej nevojave dhe disa prej rregullimeve të domosdoshme për Republikën e Kosovës, mendoj se këto 3 projektligje duhet me u kaluar dhe me hy në fuqi sa më shpejt, sepse jam absolutisht kundër idesë që të hyjnë në fuqi pas 9 muajve.

Në këtë drejtim jam pro votimit të këtyre 3 Projektligjeve dhe nëse edhe të tjerët janë dakord t'i diskutojmë vërejtjet dhe sugjerimet nga Zyra e BE-së, që të shohim nëse jemi dakord që t'i dërgojmë në formë të sugjerimeve në Komisionin Funksional.

Kryetarja tha si deputet secili i kemi vërejtjet tona, se a kanë mund të bëhen më mirë kanë mundur, por Kosova ka nevojë që ta ketë një kornizë të qartë të funksionimit të administratës.

Parimisht gjatë draftimit të këtyre 3 projektligjeve është dashtë që Zyra e BE-së të jetë e përfshirë dhe t'i jap propozimet e saj në Komisionin funksional, andaj lidhur me komentet do të ja jap fjalën përfaqësueses së zyrës së BE-së për sqarim.

Blerta Bejtullahu, përfaqësuese e Zyrës së BE-së, tha se e di që të gjitha komisionet janë ankuar se komentet kanë ardhur vonë, por ne raportin e votuar me amendamente nga Komisioni Funksional e kemi marrë të martën në mbrëmje dhe menjëherë atë natë nuk kemi arritur me i debatuar me Komisionin Funksional. Zyra jonë i ka përgatitur disa komente për atë që ka mbërritur në amendamentet e propozuara. Zyra jonë ka marrë pjesë në punëtorinë që është mbajtur në Antalya, mirëpo se çka është diskutuar dhe çka është vendos atje kur nuk është ndarë me ne.

Në punëtorinë e fundit nuk kemi qenë të ftuar. Këto janë disa komente të cilat i kemi punuar shpejt dhe për atë nuk ju kemi dërguar në mënyrë zyrtare dhe i kemi dërgua në mënyrë jo formale vetëm me ju treguar se këto kemi mbërritur me i parë në mënyrë që ju me i shqyrtuar dhe me i vlerësuar për mos me i bërë disa gabime që mos me pasur pasoja në të ardhmen. Ju nëse doni t'i shqyrtoni jeni të pavarur në vendime.

Kryetarja tha se dy nga komentet janë marrë parasysht nga Komisioni për Legjislacion, krejt komentet janë bërë në mënyrë jo zyrtare dhe komentet i kemi marrë një orë para mbledhjes, ne ju kemi ftuar që t'i diskutojmë sepse kjo mbledhje është vazhdimësi e takimit të djeshëm.

Armend Zemaj u ndërlidh në diskutim dhe tha se ju si përfaqësuese e Zyrës së BE-së duhet pasur parasysht rolin dhe mandatin e komisionit tonë, sepse tani në këtë fazë nuk mundemi të paraqesim propozime dhe nuk mund të intervenojmë në ligjin bazë.

Zenun Pajaziti tha se këto ligje nuk kanë filluar tani kur filluan grevat, por pas një debati disa vjeçar për me i rregulluar këto gjëra. Në këto ligje nuk po i bëjmë për me e kënaq një komunitet apo dikë, te shumica e deputetëve po duam ta bëjmë një zgjidhje afatgjate, shumica e këtyre lidhen me funksionimin e disa institucioneve në frymën e BE-së, debatet më të mëdha për agjencitë dhe rregullatorët i kemi pasur ku jemi bazuar në direktivat e BE-së, shumë agjenci nuk kemi dashtë me i bërë, por janë bërë se është direktivë e BE-së dhe duhet me qenë të pa varura dhe sot e kemi këtë situatë qysh e kemi.

Nuk duam me bërë diçka që pastaj pas 6 muajsh të kritikohemi në Raportin e progresit, prandaj ju duhet nga Zyra e BE-së me qenë këtu. Në grupe punuese me angazhuar ekspertë dhe me kohë me i rregulluar gjërat. Ne tani nuk jemi në situatë që mundemi me bërë ndryshime se jemi shumë vonë.

Lidhur me agjencitë dhe rregullatorët duheni me qenë më aktiv në trajtimin e tyre, BE ka deshtë me qenë të pavarura për me i shkëputur nga ndikimi politik, por ka ndodhur një ekstrem tjetër dhe keqpërdorim ekstrem i asaj pavarësie të agjencive. Në anën tjetër duhet me e diskutuar ndikimin e politikës.

Andaj do te ishte mirë ju me qenë me ne me pasur ekspertiza sa ma shumë, me punua së bashku, e jo kur të përfundohet raporti atëherë është vonë.

Blerta Bejtullahu tha se këto janë vetëm disa komente të vogla që i kemi pas në dy ligjet, por komentet më të mëdha i kishim në Ligjin për pagat dhe si kemi përfunduar.

Milaim Zeka tha se në Antalya dhe as në Brod nuk ka marrë pjesë Blerta Bejtullahu nga Zyra e BE-së, dhe kam një vërejtje se nuk është korrekte që zonja Apostollova me ardhur dhe me u takuar vetëm me kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, por duhet të takohet me të gjithë anëtarët e komisionit.

Visar Ymeri tha se unë i kam lexuar komentet Zyrës së BE-së dhe kam vërejtur se janë në formë të sugjerimeve, janë dy lloj sugjerimesh, është sugjerim serioz nëse është duke u shkelur kodi penal në te, por janë disa sugjerime tjera të cilat mundemi me i trajtua politikisht dhe me vendos në këtë drejtim, çka do të bëjmë ne, si komision, apo sugjerimi im është ne me kërkuar nga Komisioni FunkSIONAL le t'i kushtojë disa prej vërejtjeve, prapë do të jetë vendimi i komisionit se a do t'i trajtojë dhe fundi vendim i seancës se a do t' i trajtojë me seriozitet a jo.

Blerta Bejtullahu në fund tha se këto janë vetëm komente dhe nuk po duam ne me ju imponuar, por vetëm janë si këshilla apo ndihmë se ku mundeni me e përmirësuar.

Ismet Beqiri tha se të gjithë e dinë se cili është roli ynë si komision, ajo çka po me pengon dhe për mua absurd janë koeficientet e këshilltarëve të kryetarit dhe nënkryetarëve me koeficientin 6, kurse zyrtari i doganës 2.4 , pastaj konsulli 2.65, ambasadori 5.25 e kështu me radhë, edhe pse kemi nevojë shumë për ligj, por kështu nuk rregullohet, këshilltarët me e pasur koeficientin kaq të lartë e ata nuk janë staf i Kuvendit. Ata janë politik, kurse stafi i Kuvendit që punon drejtpërdrejt gjithë kohën me ne duhet me e pasur një prioritet.

Kryetarja propozoi që pasi 3 projektligjet u shqyrtuan në pako, pyeti anëtarët se a të votohen në pako. Anëtarët u pajtuan me propozimin e kryetares dhe votuan nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Pas votimit kryetarja konstatoj se komisioni me shumicë votash nxori këtë:

Rekomandim

- 1. Projektligji nr.06/L-114 për zyrtarët publik, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.**
- 2. Projektligji nr.06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.**
- 3. Projektligji nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, me amendamentet e Komisionit Funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu-Kodra